

## 1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2015

**Tabelë 1:** Veprimet e përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë\*).

| DATA       | R/REPO njëditore | R/REPO njëjavore | R/REPO njëmujore |
|------------|------------------|------------------|------------------|
| 02.04.2015 |                  | 19,390.00        | 3,000.00         |
| 09.04.2015 |                  | 16,330.00        | 2,750.00         |
| 10.04.2015 | 5,600.00         |                  |                  |
| 16.04.2015 |                  | 19,020.00        | 2,900.00         |
| 17.04.2015 | 2,960.00         |                  |                  |
| 23.04.2015 | 7,500.00         | 19,080.00        | 3,000.00         |
| 30.04.2015 |                  | 24,070.00        | 3,000.00         |
| 07.05.2015 |                  | 20,960.00        | 3,000.00         |
| 14.05.2015 |                  | 18,930.00        | 3,000.00         |
| 21.05.2015 |                  | 26,720.00        | 3,000.00         |
| 22.05.2015 | 2,630.00         |                  |                  |
| 28.05.2015 |                  | 16,580.00        | 3,000.00         |
| 04.06.2015 |                  | 17,530.00        | 4,000.00         |
| 11.06.2015 |                  | 14,780.00        | 4,000.00         |
| 18.06.2015 |                  | 20,890.00        | 4,000.00         |
| 23.06.2015 | 1,400.00         |                  |                  |
| 25.06.2015 |                  | 19,260.00        | 4,000.00         |

periudhës së mbajtjes së rezervës.

Edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit është vijuar me operacionet për shitblerje me të drejta të plota, duke synuar mbajtjen e zotërimit të Bankës së Shqipërisë në bono thesari jo më të lartë se niveli 70% i totalit të çdo emetimi. Gjatë këtij tremujori janë zhvilluar katër ankande për shitje të bonove të thesarit me afat maturimi 6-mujor, duke ulur portofolin e BSh-së në total për 2 miliardë lekë, kompensuar me tetë ankande të blerjes së bonove të thesarit 12-mujore ku janë realizuar në total për 2.5 miliardë lekë. Për rrjedhojë, në fund të gjashtëmujorit të parë, portofoli i BSh-së iu rikthye nivelit të fillimvitit.

### 1.1. Operacione të tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektim të përkohshëm të likuiditetit dhe operacione të përhershme me qëllim strukturimin e portofolit të BSH-së.

**Sasia totale e likuiditetit të injektuar ka rezultuar mesatarisht 28.35 miliardë lekë, kundrejt nivelit 21.30 miliardë lekë të regjistruar në tremujorin e parë dhe kundrejt 20.61 miliardë lekë në tremujorin e dytë të vitit të kaluar.**

Për injektimin e likuiditetit të përkohshëm, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht 19.50 miliardë lekë në javë\*, shoqëruar njëkohësisht me marrëveshje të anasjelltë riblerjeje me maturim njëmujor, mesatarisht 3.28 miliardë lekë në javë\*.

**Operacionet injektuese njëditore janë përdorur në pesë raste, të përqendruara në fund të**

\* Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.


## 1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Depozita njëditore është përdorur nga bankat tregtare në 11 raste, mesatarisht për 0.95 miliardë lekë, kundrejt 46 rasteve në tremujorin e kaluar me mesatare përdorimi 6.74 miliardë lekë.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 3 raste, pikërisht në ditët e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës, mesatarisht për 0.98 mld lekë. Në tremujorin e kaluar, instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 10 raste mesatarisht për 2.61 mld lekë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për periudhën 2011-2015.

**Grafik 1:** Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë në periudhën 2011-2015 (me çmim blerjeje)



## 2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË DYTË TË VITIT 2015

### 2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë


Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2015, Banka e Shqipërisë ka realizuar një ankand për blerjen e 2 deri në 5 milionë euro në datën 1 prill në përputhje me kalendarin e publikuar në muajin nëntor dhe objektivin për rritjen e rezervës valutore. Në ankandin e zhvilluar në muajin prill u blenë 3.73 milionë euro.

Kalendari i blerjeve të valutës së Bankës së Shqipërisë është rishikuar në maj, duke shtuar dy ankande përkatësisht në muajt gusht dhe nëntor:

Tabelë 2: Kalendari i ankandeve të blerjes së valutës 2015

| Data      | Shuma (mIn EUR) |
|-----------|-----------------|
| 01 prill  | 2-5             |
| 02 korrik | 2-5             |
| 06 gusht  | 2-5             |
| 12 nëntor | 2-5             |

Grafik 2: Ecuria e EUR/ALL dhe USD/ALL në tremujorin e dytë të vitit 2015



## 2.2. Veprime me institucione të tjera

Marrëveshjet *swap* në valutë kundrejt lekë midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave kanë zënë pjesën kryesore të veprimeve midis dy institucioneve dhe Ministria e Financave ka vijuar të menaxhojë likuiditetin duke investuar pranë Bankës së Shqipërisë tepricat në valutë. Gjatë tremujorit të kaluar ka pasur dhe shitje të valutës nga Ministria e Financave në pritje të flukseve hyrëse në valutë në të ardhmen e afërt. Si rezultat i këtyre marrëveshjeve, blerjet e Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave gjatë tremujorit të kaluar qenë 36,919.72 milionë lekë dhe shitjet qenë 31,496.02 milionë lekë. Shumat e investuara në marrëveshjet *swap* në euro erdhën në rënie nga 70 milionë euro në fund të tremujorit të parë, në 18 milionë euro në fund të tremujorit të dytë, ndërkohë që ato në SDR u rritën në 74 milionë euro në fund të tremujorit të dytë kundrejt 46 milionëve në fund të atij të mëparshëm.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 59.27 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD dhe Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA).

**Tabelë 3.** Veprime valutore me institucione të tjera

| Institucioni financiar | Blerje të valutës<br>(në milionë lekë) | Shitje të valutës<br>(në milionë lekë) |
|------------------------|--|--|
| MINISTRIA E FINANCIVE  | 36,919.72                              | 31,496.02                              |
| TË TJERA (IDA, IBRD)   | 59.27                                  |  |